



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

Anr.543/2021

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Faton Ademi kryesues, Milena Đerić dhe Adnan Konushevci anëtarë, duke vendosur lidhur me apelin e parashtruar nga Hysnije Sadikaj nga Shtetet e Bashkuara të Amerikës, paraqitur kundër Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), lidhur me mos përfshirjen në listën përfundimtare të votuesve jashtë Kosovës, për Zgjedhjet Lokale në Republikën e Kosovës që do të mbahen me datën 17 tetor 2021, në seancën e panelit të mbajtur me datë 27.08.2021, mori këtë:

V E N D I M

Refuzohet i pabazuar apeli Anr.543/2021 i paraqitur nga Hysnije Sadikaj nga Shtetet e Bashkuara të Amerikës, me të cilin kërkon që të përfshihet në listën e votuesve jashtë Kosovës.

A r s y e t i m

Me datën 27.08.2021 PZAP-i, ka pranuar një apel nga Hysnije Sadikaj nga Shtetet e Bashkuara të Amerikës, në të cilën pretendohet se ka aplikuar për regjistrim si votues jashtë Kosove, dhe se iu është refuzuar kërkesa nga ana e KQZ-së, për tu përfshirë në listën e votuesve jashtë Kosovës për Zgjedhjet Lokale që do të mbahen më 17 Tetor 2021.

Parashtruesija e apelit ka bashkangjitur imazh formularit si dëshmi lidhur me pretendimet në apel.

Paneli, pasi që shqyrtoi dhe vlerësoj të gjitha pretendimet e apelit, në kuptim të nenit 117 par.2 të LZP-së, gjeti se:

Apeli është i pabazuar

Paneli, pasi shqyrtoi lëndën konstatoi se apeli është i pabazuar pasi që parashtruesija e apelit gjatë aplikimit të tij për regjistrim për votim jashtë Kosovës, nuk i ka plotësuar kriteret të cilat kërkojnë në bazë nenit 5.1 pika a) të LZP-së ku përcaktohet: *“çdo person ka të drejtë për të votuar nëse është i regjistruar si qytetar i Kosovës në Regjistrin Qendror Civil të Kosovës”*, si dhe dispozita e nenit 3.1 të Rregullës Zgjedhore 03/2013 të KQZ-së ku përcaktohet se: *“votuesi me zotësi juridike jashtë Kosovës mund ta hedh fletëvotimin për zgjedhjet në qoftë se është regjistruar si banorë i përhershëm i Kosovës në Regjistrin Qendror civil”*.

Në përgjigjen e KQZ-se theksohet se Hysnije Sadikaj ka dërguar në vetëm aplikacionin për regjistrim, pas asnjë kopje të dokumentit që vërteton kriterin e identitetit dhe kriterin ligjor për tu përfshirë në listën e votuesve jashtë Kosovës dhe se aplikacioni i regjistrimit është i Zgjedhjeve të 14 shkurtit 2021

Nga shkresat e lëndës Paneli, vlerësoi se parashtruesi i apelit në momentin e aplikimit për regjistrim për votim jashtë Kosovës dosja e tij nuk ka qenë e kompletuar dhe nuk i ka plotësuar kriteret e përcaktuara siç parashihet me dispozitat e nenit 5.1 pika a) të LZP-së dhe të Rregullës Zgjedhore 03/2013 të KQZ-së dhe nuk i ka plotësuar kriteret e përcaktuara, andaj me të drejtë është refuzuar nga ana e KQZ-së.

Prandaj, nga arsyet e theksuara më lart si dhe duke u bazuar në dispozitat e nenit 117 par.3, 118 par.1, 122 par.1 pika a) të LZP-së, si dhe nenit 11 par.6 të Rregullës Nr.02/15 të PZAP-it, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa

A nr.543/2021 më datën 27.08.2021

Kryesuesi i Panelit
Faton Ademi



Këshillë Juridike: Kundër këtij vendimi është e lejuar ankesa, në Gjykatën Supreme të Kosovës, brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes-pranimi të këtij vendimi.